



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 507 Akti

Nr. 593 Vendimi

Tiranë, më 25.11.2022

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 23.11.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Znj. Armela Hasantari**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Armela Hasantari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 23.11.2022 kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 24.7.2020, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Armela Hasantari, me vendimin nr. 2, datë 10.11.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Komisioni, në datën 11.11.2022, e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 21.11.2022.
8. Subjekti i rivlerësimit, në datën 15.11.2022, u paraqit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 21.11.2022, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 21.11.2022, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 23.11.2022, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 23.11.2022, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.
11. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti Armela Hasantari parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 23.11.2022 u mbyll për të rifilluar më 25.11.2022 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet

publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

#### **1. Automjet tip “Mercedes-Benz A Class”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit**

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “Mercedes-Benz A-Class A 170 CDI”, prodhim i vitit 2002, me targa \*\*\*, në deklaratën e interesave privatë në vitin 2015, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*, duke bërë me dije se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\*, të datës 20.5.2015, nga pala shitëse M. K. Subjekti ka deklaruar si vlerë të automjetit shumën 2.700 euro, me burim të ardhurat nga paga e saj dhe bashkëshortit në shumën 2.000 euro dhe 700 euro nga gjendja *cash* që bashkëshorti ka pasur nga viti i mëparshëm<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se shuma prej 2.000 euro ka pasur si burim të ardhurat nga pagat e marra prej saj dhe bashkëshortit gjatë vitit 2015, ndërsa pjesa e mbetur prej 700 euro është pakësuar

2. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dosjen e plotë të automjetit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>2</sup>, ku ka rezultuar se automjeti në fjalë është blerë fillimisht nga shtetasja M. K. në shtetin gjerman, nëpërmjet faturës së datës 18.12.2012, kundrejt çmimit 900 euro<sup>3</sup>. Pas rreth 3 vjetësh, ky automjet i është shitur subjektit në vlerën 2.700 euro.

### 1.2 Analizimi i burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit

3. Komisioni ka kryer analizën financiare për harkun kohor nga fillimviti 2015 e deri në datën 20.5.2015, periudhë kur është blerë automjeti, dhe ka konstatuar se nga llogaritë bankare është tërhequr në total shuma 396.000 lekë nga subjekti dhe 298.000 lekë nga bashkëshorti. Në përfundim të kësaj analize ka rezultuar se për kryerjen e investimit në këtë pasuri subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, siç paraqitet e detajuar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 1 – Analiza financiare për blerjen e automjetit**

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2015 - 20.5.2015	396,000
Te ardhura nga paga e b/sh te subjektit 1.1.2015 - 20.5.2015	298,000
Pakesuar nga gjendja cash	96,355
Shpenzime jetese janar - maj 2015	- 170,775
Shpenzime udhetimi janar - maj 2015	- 151,415
Shpenzim per blerjen e automjetit	- 371,655
<b>Rezultati në datë 20.5.2015</b>	<b>96,510</b>

4. Meqenëse në DIPP/2015 prej subjektit nuk është deklaruar pakësimi i kursimeve të disponuara *cash* në banesë, Komisioni ka kryer analizën financiare dhe të segmentuar, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti mund t'i rikrijonin kursimet prej 700 euro me burime të ligjshme financiare, nga momenti i blerjes së automjetit deri në fund të vitit 2015. Gjithsesi, edhe nëse këto kursime nuk do të konsideroheshin si të përdorura, sërish do të rezultonte një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare – duke mos rezultuar kështu problematika lidhur me deklarimin e kësaj pasurie apo me ligjshmërinë e burimeve financiare për krijimin e saj.

### 2. Llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit

5. Subjekti ka deklaruar llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” periodikisht, duke filluar nga DIPP/2014, si dhe në deklaratën *Vetting*, në të cilën ka rezultuar e pasqyruar shuma 64.101 lekë, me burim të ardhurat nga paga.
6. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në këtë llogari bankare ka rezultuar se kjo gjendje është e krijuar nga kreditimi i shumave nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë

përkohësisht nga gjendja *cash* që bashkëshorti ka pasur nga viti i mëparshëm. Së bashku me përgjigjet e mësipërme subjekti ka paraqitur vërtetimet e tyre të pagave.

<sup>2</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020.

<sup>3</sup> Sipas faturës së blerjes së datës 18.12.2012.

25.1.2017, nga ISSH-ja për trajtimin me raport barrë lindje duke filluar nga data 28.7.2016.

7. Në dokumentacionin e paraqitur nga “Raiffeisen Bank”<sup>4</sup> ka rezultuar se gjendja në llogarinë bankare të subjektit përputhet me atë të deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*, si dhe është konfirmuar burimi i krijimit të saj me të ardhurat nga paga e subjektit.
8. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e kësaj llogarie bankare, si dhe me ligjshmërinë e burimeve financiare.

### **3. Llogari kursimi në emër të vajzës A. B.**

9. Në deklaratën *Vetting*, si dhe në DIPP/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një llogari kursimi të çelur në emër të vajzës së saj A. B., në vlerën 253.475 lekë, me burim dhurata (dhe qoka) nga familjarë dhe miq për lindjen e vajzës.
10. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në këtë llogari bankare ka rezultuar se kjo gjendje është krijuar nga dy depozitime *cash* të kryera nga bashkëshorti i subjektit, përkatësisht 140.000 lekë në datën 25.10.2016 dhe 113.475 lekë në po të njëjtën datë.
11. Në lidhje me këtë shumë subjekti nuk ka deklaruar në rubrikën e dhuratave dhe trajtimeve preferenciale të DIPP/2016 identitetin e dhuruesve dhe vlerat e përfituara veçmas prej secilit prej dhuruesve. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare dhe llogaria është konsideruar e furnizuar me të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Nga analiza financiare e vitit 2016 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të depozituar këtë shumë.

### **4. Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit**

#### **4.1. Apartament banimi në Rrugën e \*\*\*, Tiranë**

12. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e personit të lidhur, në DIPP/2014, e më pas në deklaratën *Vetting*, pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sip. 65.8 m<sup>2</sup>, me adresë: Rruga e \*\*\*, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë, në pronësi të tij në masën 25%, rivlerësuar në vlerën 4.935.000 lekë. Kjo pasuri është blerë me anë të kontratës së shitblerjes me kusht nr. \*\*\*, datë 18.10.2000, mes bashkëpronarëve M., në cilësinë e palës shitëse, dhe familjes së origjinës së bashkëshortit të subjektit në cilësinë e palës blerëse, kundrejt çmimit total 2.600.000 lekë, i cili do të likuidohet pjesërisht me një kredi bankare në shumën 2.398.000 lekë dhe pjesa e mbetur në shumën 202.000 lekë nga pala blerëse.
13. Përgjatë procesit të rivlerësimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti<sup>5</sup> ka rezultuar se ish-Banka e Kursimeve, me anë të kontratës së huas për familjet e pastreha nr. \*\*\*, datë 14.12.2000, i ka akorduar familjes së bashkëshortit

<sup>4</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2021.

<sup>5</sup> Me dorëzimin e deklaratës *Vetting* në ILDKPKI.

të subjektit shumën 1.690.000 lekë dhe një shumë të përfituar falas në vlerën 699.400 lekë, sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.

14. Nga ASHK-ja, por edhe nga verifikimi *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, nuk kanë rezultuar pasuri të tjera, veç pasurisë në analizë. Kjo pasuri ka rezultuar e regjistruar në emër të shtetasve E., F., K. dhe Sh. B., me nga ¼ pjesë/secili.
15. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka jetuar në apartamentin e ndodhur në Rrugën e \*\*\*, që nga momenti që ka lidhur martesë<sup>6</sup> e deri në datën 30.4.2020. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime për rikonstruksionin dhe mobilimin e apartamentit në fjalë. Në lidhje me kredinë e marrë nga bashkëshorti dhe familjarët e tij për blerjen e këtij apartamenti, ajo ka deklaruar se fillimisht këstet e kredisë janë paguar nga kontributet e të gjithë bashkëkredimarrësve, duke qenë se kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare deri në ndarjen nga jeta të babait të tij (viti 2008), si dhe shkëputjes së motrës nga trangu familjar dhe nga banesa në vitin 2011. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në vitet 2014 – 2018 pagesat për këstet e kredisë janë kryer nga të ardhurat e nënës dhe motrës së tij.
16. Duke konsideruar se apartamenti në fjalë është blerë mbi 14 vjet më herët nga emërimi i subjektit të rivlerësimit si gjyqtare, si dhe duke pasur në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji<sup>7</sup>, Komisioni vlerësoi se nuk kishte arsye për kryerjen e hetimeve/verifikimeve të mëtejshme lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, vetëm për faktin se apartamenti *de quo* ishte përdorur edhe nga subjekti i rivlerësimit.

#### **4.2. Automjet tip “Volkswagen Passat”, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit**

17. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar për herë të parë si person i lidhur në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2014, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*, pasurinë e llojit “automjet” tip “Volkswagen Passat”<sup>8</sup>, në vlerën 7.000 euro, me burim krijimi nga kursimet ndër vite.
18. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e dhurimit nr. \*\*\*, datë 25.3.2009, nëpërmjet së cilës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e përfaqësuar nga z. V. M., i ka dhuruar automjetin e sipërcituar z. K. B. pa ndonjë kusht.
19. Nga DPSHTRR-ja<sup>9</sup>, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare<sup>10</sup>, por edhe nga verifikimi i kryer *online* nga Komisioni, në sistemin informatik të këtij institucioni,

<sup>6</sup> Subjekti ka lidhur martesë me bashkëshortin në datën 29.8.2014.

<sup>7</sup> Shihni paragrafët 91-94 të vendimit nr. 7/2020 të Kolegjit.

<sup>8</sup> Targa ka qenë \*\*\* dhe është ndryshuar në \*\*\*\* me kalimin në pronësi të z. K. B.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2017.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2020.

shtetasi K. B., përgjatë periudhës 2012 – 2017, nuk ka rezultuar pronar/përdorues i automjeteve të ndryshme nga ai i deklaruar në pronësi të tij me targa \*\*\*.

20. Lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni mes deklarimit të kryer për automjetin në fjalë dhe dokumentacionit të administruar, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se në vitin 2009 bashkëshorti i saj ka kryer pagesën *cash* për blerjen e këtij automjeti në vlerën 7.000 euro nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>11</sup>. Pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale, disa ditë pas lidhjes së kontratës.
21. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka paraqitur një ekstrakt të lëvizjeve bankare të llogarisë së bashkëshortit, në të cilën ka rezultuar se në datën 6.4.2009 ai ka tërhequr *cash* shumën 7.000 euro, me përshkrimin “për blerje automjeti”. Subjekti ka shtuar se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga kryerja e këtij veprimi juridik, bashkëshorti nuk e kujton se përse kalimi i pronësisë së automjetit është bërë me anë të kontratës së dhurimit dhe jo me kontratë shitblerjeje. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se ky veprim juridik nga bashkëshorti është kryer disa vite përpara lidhjes së martesës.

#### **4.2.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

22. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se shuma 7.000 euro, e tërhequr në datën 6.4.2009 për blerjen e automjetit në analizë, rrjedh nga konvertimi në datën 3.4.2009 i shumës 9.500 USD.
23. Kjo shumë prej 9.500 USD është transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në po të njëjtën datë, 3.4.2009, nga një llogari dyemërore pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, e nënës dhe motrës së tij me të ardhurat e kësaj të fundit nga punësimi, konkretisht nga paga që i ka kaluar asaj në datën 1.4.2009, prej 10.648 USD<sup>12</sup>. Sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, shuma 9.500 USD ka qenë një hua mes bashkëshortit të saj dhe motrës së tij, të cilën ai e ka shlyer plotësisht *cash* në dy këste, në vitet 2009 dhe 2010.
24. Si burim të ligjshëm financiar për kthimin pas të shumës në fjalë, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe kursimet e tij ndër vite. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2022, të lëshuar prej bashkëshortit dhe motrës së tij, në të cilën kanë konfirmuar marrëdhënien në fjalë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni (e cila paraqitet e detajuar në pikën 4.4.3 të këtij vendimi) ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi për kthimin e kësaj huaje me burime të ligjshme financiare.

---

<sup>11</sup> Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore, familjare apo të çfarëdolloji tjetër me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe/ose me ortakët apo administratorët e saj (z. V. M.). Ajo ka paraqitur një vërtetim të datës 22.6.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ku rezulton se nuk ka gjykuar çështje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe me përfaqësuesin e saj (z. V. M.). Ky fakt është konfirmuar edhe me përgjigjen dërguar nga kjo gjykatë për Komisionin me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2022.

<sup>12</sup> Në mbështetje të sa më sipër, subjekti, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një vërtetim të datës 6.8.2009, të lëshuar nga shoqëria e huaj “\*\*\*\*”, ku citohet se znj. E. B. ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie në Irak dhe ka përfituar të ardhura nga paga si në vijim: për vitin 2006 ka përfituar të ardhura *bruto* në vlerën 144 USD; për vitin 2007 ka përfituar të ardhura *bruto* në vlerën 74.978 USD; për vitin 2008 ka përfituar të ardhura *bruto* në vlerën 111.783 USD; dhe për vitin 2009 ka përfituar të ardhura *bruto* në vlerën 76.496 USD.



#### **4.3. Llogari rrjedhëse në vlerën 62.986 lekë dhe llogari kursimi në vlerën 106.097 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”**

25. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendje në llogaritë e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” përkatësisht vlerat 62.998 lekë dhe 106.097 lekë.
26. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se gjendjet e deklaruara përputhen me ato të rezultuara nga hetimi administrativ.
27. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se gjendja në llogarinë rrjedhëse është krijuar nga të ardhurat e tij nga paga në Ambasadën e Mbretërisë Holandeze. Po ashtu, gjendja në llogarinë e kursimit është krijuar nga transferimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit nga llogaria e tij e pagës, me burim nga të ardhurat nga paga e tij.

#### **4.4. Llogari kursimi në vlerën 45.101 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”**

28. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë e mësipërme të kursimit me burim nga kursimet ndër vite, të ardhura nga pagat në Ambasadën Holandeze dhe punëdhënës të mëparshëm.
29. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në këtë llogari bankare ka rezultuar se kjo shumë prej 45.101 euro është krijuar nëpërmjet veprimeve, si vijojnë:
  - a. këmbimi i shumës 1.086 euro nga llogaria e tij prej 1.203 USD në datën 27.10.2016;
  - b. këmbimi i shumës 16.000 euro nga llogaria e tij prej 2.200.000 lekë në datën 18.1.2017;
  - c. depozitimi *cash* i shumës 28.000 euro me përshkrimin “të ardhura të dhëna hua dhe që po rikthehen në bankë” në datën 26.1.2017.
30. Këto veprime janë deklaruar në DIPP/2016 nga bashkëshorti i subjektit, ku për depozitim të shumës 28.000 euro është deklaruar kthimi i huave nga palët e treta, të përmendur në rubrikën e të dhënave konfidenciale, përkatësisht “*kthim i borxhit nga \*\*\* sh.p.k., në shumën 20.000 euro, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës*” dhe “*kthim i borxhit nga E. B., themeli në shumën 8.000 euro, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2015*”.
31. Nga shqyrtimi në vijim të llogarive bankare ka rezultuar se shuma në analizë prej 45.000 euro është përdorur më tej nga subjekti dhe bashkëshorti për shlyerjen e njërit prej kësteve për blerjen e apartamentit<sup>13</sup> të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 9.8.2019, të shoqëria sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit total 172.560 euro, të deklaruar prej subjektit edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 1.
32. Kësti i parë është paguar në datën 22.8.2019, në shumën 65.000 euro, ndërsa kësti i dytë është paguar pjesërisht në shumën 13.000.000 lekë, në datën 17.10.2019, me burim nga kredia bankare e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” nëpërmjet kontratës

<sup>13</sup> Subjekti ka sqaruar se banesa në fjalë nuk është përdorur asnjëherë prej saj apo bashkëshortit, për shkak se nuk është ende tërësisht funksionale. Për këtë arsye ata banojnë në apartamentin e marrë me qira.

së kredisë nr. \*\*\*, datë 4.10.2019. Në vijim, në datën 17.10.2019, është plotësuar kësti i dytë me shumën 2.890 euro, për të cilin si burim janë deklaruar të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit ndër vite.

33. E pyetur nga Komisioni në lidhje me marrëdhënie të mundshme shoqërore/familjare apo të çfarëdolloji, përfshirë konfliktin e mundshëm të interesave me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. (përfshirë administratorin dhe/ose ortakët e saj), subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shoqërore apo familjare<sup>14</sup>. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se nga data 1.5.2020 e në vijim ka banuar në apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të shtetas L. B. Këtë apartament e ka marrë me qira bashkëshorti i saj kundrejt pagesës mujore 30.000 lekë, e paguar *cash*.
34. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë të apartamentit, si dhe aktmarrëveshjen për periudhën 1.5.2020 – 31.10.2022. Subjekti ka sqaruar se nuk ka marrëdhënie shoqërore apo familjare me shtetasen L. B. dhe as nuk ka gjykuar çështje me palë këtë shtetase. Në mbështetje të deklaramit të saj, ajo ka paraqitur vërtetimin e datës 22.6.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ku rezulton se nuk ka gjykuar çështje me shtetasen L. B. konfirmuar nga gjykata dhe me shkresën dërguar Komisionit.
35. Përgjatë hetimit administrativ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kërkesës së dërguar nga Komisioni, është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë/administratorin dhe/ose ortakët e saj. Ky fakt është konfirmuar edhe nga një vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 22.6.2022<sup>15</sup>.

#### **4.4.1 Analizimi i burimeve për shumën 1.086 euro**

36. Nga shqyrtimi i llogarive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se në datën 17.10.2014 ai ka depozituar në llogari shumën 1.203 USD, me përshkrimin “kursime”. Në datën 27.10.2016 e ka konvertuar këtë shumë në vlerën 1.086 euro.
37. Komisioni ka kryer analizën financiare për bashkëshortin e subjektit për vitin 2014, nga e cila ka rezultuar se ai mund t’i krijonte këto kursime me burime të ligjshme financiare nga të ardhurat e tij nga pagat e këtij viti.

#### **4.4.2 Analizimi i burimeve për shumën 16.000 euro**

38. Nga shqyrtimi i llogarive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur në llogarinë e tij të kursimit shumën 2.200.000 lekë, e cila është krijuar nga transfertat periodike të kryera nga llogaria e tij e pagës në këtë llogari. Konkretisht, bashkëshorti i subjektit ka transferuar rreth 700.000 lekë gjatë periudhës tetor - dhjetor 2015 nga pagat e kredituara për periudhën shtator - nëntor 2015 në vlerën 1.022.919 lekë. Po ashtu, ai ka transferuar shumën 1.500.000 lekë gjatë vitit 2016 nga pagat e kredituara gjatë kësaj periudhe në vlerën 2.476.588

<sup>14</sup> Nga vërtetimi i datës 22.6.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rezultuar se subjekti nuk ka gjykuar çështje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe/ose me ortakët apo administratorët e saj.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2022.

lekë. Në datën 18.1.2017 bashkëshorti i subjektit ka konvertuar shumën 2.200.000 lekë në 16.000 euro.

39. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se është konfirmuar burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së sipërcituar me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga pagat.

#### **4.4.3 Analizimi i burimeve për shumën 28.000 euro**

40. Kjo shumë është depozituar nga bashkëshorti i subjektit në datën 26.1.2017 me shumat e kthyer pas nga huamarrësit, përkatësisht 20.000 euro nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe 8.000 euro nga motra e bashkëshortit të subjektit.
41. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm financiar të krijimit të shumave 20.000 euro dhe 8.000 euro të dhëna hua, duke bërë me dije gjithashtu mënyrën dhe kohën e dhënies e të shlyerjes së shumave në fjalë.
42. Subjekti, në përgjigjet e saj, është shprehur se bashkëshorti shumën prej 20.000 euro e ka transferuar nëpërmjet llogarisë së tij bankare në favor të shoqërisë huamarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 13.12.2012, ndërsa shumën prej 8.000 euro e ka tërhequr *cash* nga llogaria e tij bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 3.8.2015. Këto shuma i janë kthyer *cash* atij në janar të vitit 2017. Ajo ka bërë me dije gjithashtu se për shkak të marrëdhënies së posaçme me të motrën, bashkëshorti nuk e ka formalizuar me ndonjë akt shkresor marrëdhënien e sipërcituar. Ndërsa për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. ajo është shprehur se administratori i kësaj shoqërie, z. F.K., jeton jashtë Shqipërisë prej vitesh dhe se bashkëshorti i saj nuk ka më kontakte.
43. Gjithashtu, bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2022, në të cilën znj. E. Th. ka deklaruar, ndër të tjera, se: *“Në datën 3.8.2015, vëllai im K. B. më ka dhënë hua në shumën 8.000 euro cash, të cilën ia kam shlyer po cash në janar të vitit 2017”*.

#### **a. Lidhur me shumën 20.000 euro**

44. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit i ka dhënë hua shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shumën 20.000 euro nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 13.12.2012. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të mëtejshme të kësaj llogarie ka rezultuar se në datën 1.11.2013 shoqëria huamarrëse i ka kthyer me transfertë bankare bashkëshortit të subjektit shumën 12.000 euro me përshkrimin “kthim borxhi”. Subjekti ka sqaruar se në shkurt të vitit 2014, bashkëshorti i saj i ka dhënë *cash* përsëri hua shumën 12.000 euro shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k, duke mbetur sërish huaja e dhënë në vlerën 20.000 euro.
45. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se shuma 20.000 euro, që i është dhënë fillimisht hua shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ishte pjesë e shumës 24.000 euro të transferuar më herët në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nga motra e tij, në datën 21.2.2012, me përshkrimin “kthim borxhi”. E pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se shumën e mësipërme bashkëshorti ia kishte dhënë hua të motrës në vitin 2011, *cash*, për një

investim. Ky investim në vijim nuk është kryer prej saj, për rrjedhojë ajo ia ka rikthyer shumën bashkëshortit.

46. Komisioni ka kryer analizën financiare të bashkëshortit të subjektit për krijimin me burime të ligjshme të kursimeve në masën 24.000 euro, të cilat ai ia kishte dhënë hua motrës së tij në vitin 2011. Në mungesë të një dokumenti të kohës për momentin e dhënies së kësaj huaje Komisioni ka konsideruar maksimalisht fundin e vitit 2011 si periudhë fundore të analizës së kryer.
47. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka realizuar të ardhura nga pagat e tij për periudhën 2008 – 2011 shumën 6.926.025 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes dhe kursimeve të tij në llogaritë bankare ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit arriti të kursente shumën 24.000 euro me burime të ligjshme financiare për t’ia dhënë hua motrës së tij.

**Tabela nr. 2 – Analiza financiare për dhënien dhe kthimin<sup>16</sup> e huas**

Te ardhura te bashkeshortit 2007 - 2011	6,926,025
Shpenzime jetese 2007 - 2011	- 1,776,060
Ndryshimi likuiditeteve	- 279,486
Kthyer huaja e marrë për automjetin 7.000 Euro	- 965,930
Dhene hua motres 24.000 Euro	- 3,319,200
<b>Rezultati në 2011</b>	<b>585,349</b>

48. Për sa kohë huaja në vlerën 24.000 euro është deklaruar se nuk është përdorur prej motrës së subjektit dhe është rikthyer, nuk kanë rezultuar problematika lidhur me ligjshmërinë e saj.
49. E pyetur nga Komisioni në lidhje me dokumentacionin që provon marrëdhënien e huas së bashkëshortit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se mes bashkëshortit dhe shoqërisë në fjalë nuk ka pasur kontratë huaje formale. Marrëdhënia fillestare e huas, sipas subjektit, rezulton e provuar nga transfertat bankare e datës 13.12.2012 nga llogaria e bashkëshortit të saj në llogarinë bankare të shoqërisë huamarrëse dhe transfertat e datës 1.11.2013 nga llogaria bankare e shoqërisë në llogarinë e bashkëshortit. Subjekti ka deklaruar se duke qenë se veprimet e mëtejshme të bashkëshortit me shoqërinë e sipërcituar janë kryer pa akte formale dhe *cash*, ajo është në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor, që të provojë dhënien përsëri të shumës 12.000 euro nga ana e bashkëshortit dhe kthimin e shumës 20.000 euro nga shoqëria, pasi bashkëshorti nuk ka arritur të kontaktojë me administratorin e kësaj shoqërie, pavarësisht se është munduar disa herë.
50. Subjekti ka paraqitur një kopje të ekstraktit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe pasqyrat financiare të viteve 2016 dhe 2017, të depozituara pranë QKB-së, nga shqyrtimi i të cilave ka rezultuar se për vitin 2016 shoqëria ka realizuar të ardhura

<sup>16</sup> Përfshirë këtu edhe shuma 7.000 euro, e kthyer nga bashkëshorti i subjektit në vitet 2009 dhe 2010, motrës së tij, përdorur më herët për blerjen e automjetit, trajtuar në pikën 4.2.1 të vendimit.

në shumën 14.379.285 lekë dhe ka pasur likuiditete në bankë shumën 10.045.801 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për shlyerjen e huas së sipërpërmendur.

51. Gjithashtu, nga ekstrakti i QKB-së ka rezultuar se shoqëria në fjalë ka pasur një barrë sigurie mbi titujt e pronësisë me nr. \*\*\* prot., prej datës 30.3.2015, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore. Ndërkohë, nga lëvizjet e llogarive bankare të kësaj shoqërie ka rezultuar se në datën 1.12.2016 nga administratori i shoqërisë është kryer një tërheqje *cash* në shumën 23.180 euro.
52. Në lidhje me marrëdhënie të mundshme familjare, shoqërore, juridike apo të çfarëdolloji, përfshirë edhe situatën e mundshme të konfliktit të interesave për çështje të shqyrtuara me palë shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., administratorët dhe/apo ortakët e saj, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie me ta. Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 22.6.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se nuk ka gjykuar çështje me shoqërinë në fjalë, ortakët apo administratorët e saj, konfirmuar kjo edhe nga shkresa e gjykatës dërguar Komisionit<sup>17</sup>.

#### **b. Lidhur me shumën 8.000 euro**

53. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 8.000 euro nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”, më 3.8.2015. Kjo shumë është krijuar nga një depozitim i kryer nga bashkëshorti i subjektit në datën 17.10.2014, i shumës 3.065 euro, me përshkrimin “të ardhura nga dasma dhe kursime”, si dhe një konvertim i shumës 5.680 euro nga llogaria e kursimit, më 3.8.2015.
54. Shuma 793.496 lekë, e konvertuar nga bashkëshorti i subjektit në vlerën 5.680 euro, është krijuar nga një depozitim i shumës 400.000 lekë, në datën 17.10.2014, me burim nga “kursime dhe të ardhura nga dasma”, si dhe nga transferimet periodike nga llogaria e pagës së bashkëshortit të subjektit, në llogari kursimi, të cilat deri në datën 3.8.2015 kanë qenë në masën 600.000 lekë.
55. Sa u përket shumave 3.065 euro dhe 400.000 lekë – të depozituara nga bashkëshorti i subjektit, në të njëjtën ditë dhe me të njëjtin përshkrim, duke përfshirë si burim të tyre kursimet, si dhe të ardhurat nga dasma – në mungesë të evidentimit të pjesës takuese të secilit prej përbërësve të këtyre shumave, si dhe identitetit të dhuruesve apo vlerat e përfituara veçmas prej secilit prej tyre, Komisioni ka konsideruar si burim vetëm të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
56. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën janar 2013 – tetor 2014 të bashkëshortit të subjektit, duke përlogaritur të ardhurat, shpenzimet e jetesës, si dhe ndryshimin në likuiditetet, përfshirë këtu gjendjet në llogaritë e tij bankare dhe ato në gjendje *cash* – pas së cilës ka rezultuar se shumat

---

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2022.

e mësipërme mund të kurseheshin nga bashkëshorti i subjektit me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 3 – Analiza financiare për depozitimin e shumave**

Te ardhura te bashkeshortit janar 2013 - tetor 2014	3,929,927
Shpenzime jetese janar 2013 - tetor 2014	- 648,711
Gjendja e llogarive ne janar 2013	500,997
Gjendja e llogarive ne tetor 2014	- 1,235,334
Gjendje cash ne tetor 2014	- 700,550
<b>Rezultati në 31.10.2014</b>	<b>1,846,328</b>

57. Ndërsa, sa i përket kthimit pas të kësaj shume nga motra e bashkëshortit të subjektit në janar të vitit 2017, Komisioni ka përlllogaritur tërheqjet e kryera *cash* prej saj nga llogaria e pagës për periudhën pas marrjes së huas deri në janar të vitit 2017, si dhe shpenzimet e jetesës së familjes. Nga kjo analizë ka rezultuar se ajo ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për t'i kthyer huan në vlerën 8.000 euro bashkëshortit të subjektit.

**Tabela nr. 4 – Analiza financiare për kthimin e huas nga motra e subjektit**

Te ardhura te motres se b/sh shtator 2015 - janar 2017	2,144,853
Shpenzime jetese shtator 2015 - janar 2017	- 988,325
Kthyer bashkeshortit te subjektit, 8.000 Euro	- 1,082,160
<b>Rezultati në janar 2017</b>	<b>74,368</b>

58. Në përfundim të sa më sipër, nëpërmjet rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor për të provuar momentin dhe mënyrën e kthimit të huas me vlerë 20.000 euro nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe të jepte shpjegime bindëse mbi mosdeklarimin e kthimit të kësaj huaje në deklaratën *Vetting*, si njërin prej burimeve të krijimit të depozitës me vlerë 45.000 euro.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

59. Subjekti ka deklaruar se është në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion ligjor kthimin në *cash* të huas nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ndonëse nga ana e saj dhe bashkëshortit janë bërë përpjekje maksimale në drejtim të provueshmërisë së marrëdhënies së huas dhe kthimit të saj. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.11.2022, të lëshuar nga z. Z. K. (vëllai i z. F. K., i cili ka deklaruar se i vëllai prej vitesh ndodhet jashtë vendit dhe ka humbur kontaktet me familjarët e tij. Subjekti është shprehur se, ashtu sikurse ka rezultuar edhe nga hetimi i Komisionit, nga lëvizjet e llogarive bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. ka rezultuar një tërheqje *cash* në shumën 23.180 euro, në datën 1.12.2016 (një muaj përpara kthimit të shumës hua bashkëshortit), fakt i cili provon se kjo shumë me shumë mundësi ka shërbyer për kthimin e huas. Për të gjitha sa më sipër, subjekti ka kërkuar që fakti i pretenduar duhet të konsiderohet i provuar në përputhje me nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve kushtetuese lidhur me këtë situatë.

60. Lidhur me deklarinimin në deklaratën *Vetting* nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit, subjekti është shprehur se ai ka deklaruar llogarinë e kursimit në shumën 45.000 euro, me burim kursimet ndër vite dhe të ardhura nga pagat, por bashkëlidhur kësaj deklarate ai ka depozituar lëvizjet e llogarisë, nga përmbajtja e së cilës rezulton se në lidhje me depozitimimin e shumës 28.000 euro *cash* ka vendosur përshkrimin “të ardhura të dhëna hua dhe që po rikthehen në bankë”. Subjekti ka sqaruar se, ndonëse nuk është përmendur në mënyrë të qartë si burim kthimi i shumës 20.000 euro nga shoqëria në fjalë, ai rezulton i provuar nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga bashkëshorti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.
61. Burimi financiar i bashkëshortit për krijimin e shumës së dhënë hua 20.000 euro janë të ardhurat nga paga dhe kursimet ndër vite të tij, çka do të thotë që ai i është referuar burimit fillestar të krijimit të kësaj shume. Po ashtu, në DPV/2016, bashkëshorti, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar kthimin e huave, çka subjekti ka kërkuar të merret si provë nga Komisioni, referuar qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit se deklaratat periodike vjetore kanë efekt të plotë provues sa u përket pasurive të subjekteve ndër vite, ashtu edhe deklarinimit të burimit të krijimit të tyre. Së fundmi, subjekti është shprehur se edhe nëse ka pasaktësi në burimin e deklarinimit nga personi i lidhur me të, këto pasaktësi nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e deklarinimit.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

62. Lidhur me marrëdhënien e huas, trupi gjykues vlerëson se lëvizjet e konstatuara në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit – lidhur me: (i) transferimin në vitin 2012 të shumës 20.000 euro nga llogaria e tij në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; dhe kthimin e pjesshëm të shumës 12.000 euro nga llogaria e shoqërisë në favor të bashkëshortit të subjektit në vitin 2013, me përshkrimet “depozitë” dhe “kthim borxhi” – të cilat, të ndërthurura me deklarinimin e bashkëshortit të subjektit në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2014 (duke përshkruar dhënien e huas prej 20.000 euro), por edhe në deklarinimet e tij të mëtejshme, evidentojnë ekzistencën e marrëdhënies së huas mes tyre.
63. Lidhur me mundësitë financiare të krijimit të shumës 20.000 euro nga huamarrësi (shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.), nga analiza e bilanceve vjetore të kësaj shoqërie, duke mbajtur në konsideratë qarkullimet dhe fitimet e realizuara në vitet pararendëse të kthimit të huas, ka rezultuar një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare prej saj. Gjithashtu, edhe tërheqja e shumës 23.000 euro në dhjetor të vitit 2016 – ndonëse nuk është e provuar totalisht që është përdorur për shlyerjen e kësaj huaje – përbën një tjetër *indicie* që indirekt konfirmon mundësinë e disponimit *cash* të shumës në fjalë, pikërisht në periudhën në analizë, e kësajsoj mbështet edhe deklarinimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për kthimin e kësaj huaje në janar të vitit 2017.
64. Në përmbledhje të sa më sipër – duke mbajtur në vëmendje edhe ekzistencën e një barre sigurie mbi llogaritë bankare të shoqërisë në fjalë, e cila mund të ketë induktuar administratorin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në një lëvizje të shumave të parave në

gjendje *cash* – kthimi në janar të vitit 2017 vlerësohet i mundshëm dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë në vetvete shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

65. Për më tepër, në konfirmim të sa më sipër – vlerësimi që shuma në fjalë e depozituar prej 20.000 euro, si pjesë përbërëse e depozitës prej 45.101 euro, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit – mbështetet gjithashtu në faktet se: (i) kjo marrëdhënie ka qenë e krijuar prej bashkëshortit të subjektit me të ardhurat e tij, pra me burime të ligjshme të konfirmuara; (ii) kjo marrëdhënie ka nisur prej vitit 2012, pra disa vite përpara fillimit të detyrës si stazhiere nga ana e subjektit të rivlerësimit; dhe (iii) edhe nëse nuk do të konsiderohej disponibiliteti i kësaj shume si kthim huaje, gjithsesi, bashkëshorti i subjektit – përpos pasaktësive të mundshme në deklarime – duket se ka pasur mundësi kursimi nga të ardhurat e tij personale, të cilat në një rrugë alternative do të mund të justifikonin krijimin dhe depozitimin në janar të vitit 2017 të shumës së mësipërme prej 20.000 euro, objekt vlerësimi.

### **5. Lidhur me disa veprime bankare të kryera nga familjarët e subjektit**

66. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni kanë rezultuar të raportuara disa veprime bankare të kryera në bankat e nivelit të dytë nga nëna e subjektit dhe bashkëshorti i subjektit dhe nëna e tij, për të cilat Komisioni i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije qëllimin e kryerjes së këtyre veprimeve, si dhe burimin e ligjshëm të shumave të depozituara *cash*.
67. Në përgjigjet e saj, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nëna e saj dhe nëna e bashkëshortit nuk janë në rrethin e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk kanë qenë dhe nuk janë pjesë e trungut të saj familjar, si dhe nuk janë në asnjë lloj marrëdhënieje huaje, dhurimi apo çfarëdolloj marrëdhënie tjetër interesi me të. Ajo ka shtuar se veprimet bankare të kryera prej tyre nuk i kanë sjellë asaj apo bashkëshortit ndonjë të drejtë apo detyrim.
68. Përveç transaksioneve të trajtuara më sipër ka rezultuar një depozitë në datën 8.4.2016 nga nëna e bashkëshortit në llogarinë e saj, në vlerën 30.000 euro. Në veprimin bankar ka rezultuar përshkrimi “të ardhura kthim borxhi”. Subjekti ka bërë me dije se kjo shumë ka si burim të ardhurat dhe kursimet e tyre (bashkëshortit, vjehrrës, vjehrrit dhe kunatës) familjare ndër vite. Në lidhje me shënimin e përdorur nga banka “të ardhura kthim borxhi”, ajo është shprehur se vjehrra e saj nuk është në dijeni se përse nga punonjësja e bankës është bërë ky shënim, pasi ajo ka deklaruar si burim të ardhurat dhe kursimet familjare të tyre ndër vite<sup>18</sup>.

---

<sup>18</sup> Subjekti ka deklaruar se vjehrra e saj F. B. nga viti 1990 deri në vitin 2014 ka qenë në marrëdhënie pune në mënyrë të pandërprerë pranë institucionit Shpërndarja e Librit Shkollor. Ndërsa vjehrra Sh. B. nga viti 1990 deri në 2004 ka qenë i punësuar pranë ish-Institutit të Studimeve dhe Projektmeve. Znj. E. B. Th. fillimisht ka punuar për KBR Kampi B., Kosovë, nënkontraktor i ushtrisë amerikane prej shtatorit 1999 deri në dhjetor 2001. Në periudhat prej prillit 2003 deri në nëntor 2006, dhe më pas prej gushtit 2009 deri në janar 2017, ka punuar për Ambasadën Amerikane në Tiranë. Në periudhën nëntor 2006 – korrik 2009 ajo ka punuar për shoqërinë amerikane “\*\*\*”, nënkontraktor i ushtrisë amerikane.



69. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të nënës së bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se shuma 30.000 euro, e depozituar në vitin 2016, është investuar në depozitë me afat dhe ka vijuar të qëndrojë e investuar së paku deri në gusht të vitit 2020.
70. Ndonëse kjo shumë nuk i është dhuruar apo dhënë hua subjektit të rivlerësimit apo të jetë përdorur për ndonjë investim të përbashkët me të – nisur nga fakti që nëna e bashkëshortit të subjektit përgjatë periudhës së rivlerësimit ka jetuar me ta – Komisioni ka analizuar mundësinë e familjes së origjinës së bashkëshortit për të kursyer shumë prej 30.000 euro, në mënyrë që të depozitohet në vitin 2016.
71. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se, duke filluar nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2013<sup>19</sup>, familja e origjinës së bashkëshortit të subjektit (duke përfshirë këtu të ardhurat deri në momentin e shkëputjes së secilit prej fëmijëve nga trangu, konkretisht të kumatës së subjektit deri në vitin 2010 dhe të bashkëshortit të subjektit deri në vitin 2013), kanë realizuar të ardhura nga pagat në vlerën 43.304.083 lekë, të cilat janë dukshëm të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë – prej 3.991.014 lekësh – si dhe për të kursyer shumë prej 30.000 euro për t'u depozituar gjatë vitit 2016 me burime të ligjshme financiare.

#### **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

72. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
73. Në analizën e njoftuar subjektit, në të cilën ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2014, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv për të kryer të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara apo të konstatuara nga Komisioni.

---

<sup>19</sup> Komisioni ka segmentuar periudhën e analizës financiare deri në fund të vitit 2013, në mënyrë që të analizohet mundësia e kursimit vetëm me të ardhurat e realizuara nga familja e origjinës së bashkëshortit përpara martesës ligjore dhe përpara fillimit të detyrës nga subjekti në vitin 2014.

**Tabela nr. 5 – Analiza financiare për periudhën nëntor 2014 – janar 2017**

	<b>Nën-Dhj 2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>26.1.2017</b>
<b>PASURI</b>	<b>2,099,410</b>	<b>646</b>	<b>1,798,458</b>	<b>3,903,511</b>
Automjet Mercedes Benz A170		371,655		
Ndryshim likuiditeti	2,099,410	-371,009	1,798,458	3,903,511
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>2,099,496</b>	<b>1,728,487</b>	<b>3,526,944</b>	<b>7,430,455</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>-1,101,200</b>	<b>0</b>	<b>3,787,560</b>
Dhënë hua/kthyer shoqërisë M. sh.p.k.				2,705,400
Dhënë hua E. Th.		-1,101,200		1,082,160
Kredi pranë Union Bank				
<b>PASURI NETO</b>	<b>2,099,410</b>	<b>1,101,846</b>	<b>1,798,458</b>	<b>115,951</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>2,663,698</b>	<b>3,658,247</b>	<b>3,698,197</b>	<b>262,836</b>
Të ardhura të subjektit	87,457	998,005	897,141	59,629
Të ardhura të bashkëshortit	441,276	2,350,233	2,491,020	177,439
Të ardhura të nënës së bashkëshortit	199,081	310,009	310,036	25,768
Të mbartura nga b/sh perpara martese	1,935,884			
<b>SHPENZIME</b>	<b>264,120</b>	<b>982,596</b>	<b>879,625</b>	<b>58,773</b>
Shpenzime jetese	109,999	672,828	705,276	58,773
Shpenzime udhëtimi/transporti	154,121	277,668	142,749	0
Shpenzim për siguracion automjeti		32,100	31,600	
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>300,168</b>	<b>1,573,805</b>	<b>1,020,114</b>	<b>88,112</b>
<i>Likuiditetet</i>				
Gjendje cash në banesë në lekë	700,550	688,250	676,350	676,350
Gjendje në llogaritë bankare	1,398,946	1,040,237	2,850,594	6,754,105
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>	<b>0</b>			

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

74. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Armela Hasantari.
75. Me shkresën e datës 26.4.2022, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikimet e kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.
76. Në vijim të kërkesës së Komisionit, datë 8.6.2022, për një përditësim dhe deklasifikim të raportit të tyre, DSIK-ja, me shkresën datë 21.6.2022, ka përcjellë raportin e sipërcituar, të deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së.
77. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë e përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit

të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ajo ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

78. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLD-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Armela Hasantari, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLGJ-ja**

79. Raporti nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2021, i përcjellë nga KLGJ-ja, është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, i cili ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (b) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (c) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

80. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtarja përgjithësisht përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor dhe parimin e disponibilitetit të padisë.

81. Subjekti i rivlerësimit nga tetori i vitit 2014 ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjyqtarja ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, po ashtu një tipar i mirë i punës së saj është zhvillimi i seancave në sallë gjykimi dhe dokumentimi i tyre me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

82. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet dhe në çdo dosje të vëzhguar gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.
83. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk janë konstatuar të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Armela Hasantari dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

## **C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

84. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
85. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, përgjithësisht, sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale, veç tejkalimit në disa raste të afatit procedural të zbardhjes së vendimeve dhe dorëzimit të akteve në sekretarinë e gjykatës.
86. Konkretisht: (i) dosja gjyqësore nr. 1, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 27.2.2015 nga gjyqtarja – pas 17 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile; (ii) dosja gjyqësore nr. 2, së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar në datën 2.3.2015 nga gjyqtari – pas 13 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile; (iii) dosja gjyqësore nr. 3 dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretari në datën 26.1.2015, 11 ditë nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile.
87. Komisioni ka konstatuar se në një rast Gjykata e Apelit për ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.4.2015 (që i përket dosjes nr. 2), të dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe kthimin për rigjykim me tjetër trup gjykues. Me këtë vendim gjyqtarja Armela Hasantari kishte vendosur: “Pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur ‘\*\*\*’ sh.a. për t’i paguar paditësit ‘\*\*\*’ sh.p.k. shumën prej 56.484,27 euro si detyrim kontraktor të papaguar, që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes me nr. \*\*\*, datë 5.12.2009, si dhe kamatat ligjore mbi këtë shumë”. Vendimi i sipërcituar ishte dhënë në mungesë të palës së paditur. Kjo e fundit ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.
88. Përgjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar vendimin nr.\*\*\*, datë 26.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranë, pas shqyrtimit dhe analizimit të çështjes në

tërësinë e saj, ka konkluduar se vendimi nr. \*\*\*, datë 7.4.2015, i dhënë nga gjyqtarja Armela Hasantari, është rrjedhojë e shkeljeve procedurale dhe, si i tillë, bazuar në nenin 466/ç të Kodit të Procedurës Civile, duhet të prishej dhe të dërgohej për gjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

89. Në lidhje me sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime lidhur me respektimin e të drejtave të palëve për të pasur një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar prej saj.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

90. Subjekti ka shpjeguar se gjykimi i çështjes në fjalë, e cila është finalizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.4.2015, ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 9 ditë, në intervalin kohor 29.1.2015-7.4.2015. Ky afat është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit të Sistemit të Vlerësimit.
91. Subjekti ka deklaruar se pala e paditur, në rastin konkret shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., është njoftuar rregullisht për çdo seancë gjyqësore, si dhe i është njoftuar edhe një kopje e padisë dhe provave bashkëlidhur saj. Për këtë çështje janë zhvilluar 8 seanca gjyqësore (1 përgatitore dhe 7 gjyqësore). Për të gjitha seancat pala e paditur është njoftuar nga nëpunësi i gjykatës nëpërmjet shërbimit postar në adresën e përcaktuar, por ka refuzuar marrjen dijani. Shënimi i nëpunësit postar “refuzon marrjen dijani” është kryer në prani të një dëshmitari. Në të njëjtën adresë ku janë komunikuar fletëthirrjet për seancat gjyqësore, palës së paditur i është komunikuar edhe vendimi gjyqësor i datës 7.4.2015 nga kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë vendim pala e paditur ka marrë menjëherë dijani dhe në datën 19.5.2015 ka ushtruar ankim ndaj tij në Gjykatën e Apelit Tiranë. Veprimet procedurale janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore që përcaktonte Kodi i Procedurës Civile i kohës në nenet 130-132 të tij.
92. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave fletëthirrjet e palës së paditur, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. etj., si dhe kopje të fletëve të Regjistrat Themeltar Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
93. Në lidhje me konstatimin se vendimet gjyqësore për dosjet 1, 2 dhe 3 janë arsyetuar tej afatit të parashikuar në ligj, në një vonesë përkatësisht me 7 ditë, 3 ditë dhe 1 ditë, subjekti ka shpjeguar se për këto çështje i ka kushtuar rëndësi cilësisë së arsyetimit të vendimit, duke u nisur edhe nga diskutimet mbi ligjin dhe faktin që shtroheshin në to. Sipas shpjegimeve të subjektit, këto dosje i përkasin periudhës së stazhit profesional dhe praktikisht vitit të parë të punës si gjyqtare dhe të gjitha rastet kanë qenë precedentë ku subjekti krijonte praktikën për herë të parë. Ndërsa, për sa i përket afatit procedural të kohëzgjatjes së gjykimit, subjekti ka parashtruar se gjykimi për çështjet e mësipërme ka qenë brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Konkretisht: për dosjen nr. 1 gjykimi ka zgjatur gjithsej 29 ditë, në intervalin kohor 28.1.2015 – 26.2.2015; për dosjen nr. 2, gjykimi ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 9 ditë, në intervalin kohor 29.1.2015 – 7.4.2015; për

dosjen nr. 3, gjykimi ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 21 ditë, në intervalin kohor 17.2.2015 – 8.5.2015.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

94. Trupi gjykues, pasi ka analizuar dhe vlerësuar me objektivitet shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në raport dokumentet e administruara dhe konstatimet e përcjella, për sa i përket respektimit të të drejtave procedurale të palëve në procesin gjyqësor, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe ligjore se nga ana e saj është respektuar afati dhe procedura për njoftimin e palëve, siç parashikohet në nenet 131-132 të Kodit të Procedurës Civile të kohës. Fakti që vendimi objekt denoncimi është prishur e kthyer për gjykim nga Gjykata e Apelit, nuk nënkupton domosdoshmërisht zgjidhje të gabuar apo shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.
95. Për sa i përket shkaqeve të cilat kanë çuar në zgjatje të afateve të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, ku pjesërisht ka ndikuar edhe kompleksiteti i çështjeve, nga një vlerësim tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.
96. Gjithashtu, edhe duke iu referuar një rasti të përshkruar më sipër, si dhe metodologjisë së vlerësimit periodik të magjistratëve, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, vërehet se nuk parashikohet si instrument matës i aftësive për gjykim apo arsyetim ligjor të tyre qëndrimi që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet përkatëse të subjekteve nën vlerësim profesional.
97. Në përfundim, Komisioni çmon se nuk janë konstatuar shkelje konkrete procedurale apo dobësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti, të cilat mund të kualifikoheshin si mangësi në aftësitë profesionale të saj.

### **DENONCIME NGA PUBLIKU**

98. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 4 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo indicie mbi të cilat të mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm. Ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente dhe informacione shtesë, siç janë trajtuar në vijim:

#### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2021, i shtetasit I. S.**

99. Denoncuesi, i cili ka qenë palë në procesin gjyqësor të finalizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.6.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka pretenduar se ky vendim ka qenë i paarsyetuar, i pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas denoncuesit, gjyqtarja

Armela Hasantari nuk ka marrë në konsideratë pretendimin e tij. Ajo ka bërë një raport sipërfaqësor të rrethanave dhe fakteve, duke shmangur ato rrethana të cilat qartazi evidentonin ekzistencën e faktit penal, duke konkluduar se veprimet e Prokurorisë kanë qenë ezauruese.

100. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se vendimi i sipërcituar është zbardhur në tejkalim të afatit të përcaktuar në ligj, çka ka ndikuar në të drejtën e ankimit ndaj tij<sup>20</sup>.
101. Në analizë të denoncimit, por edhe nga aktet e administruara përgjatë hetimit në lidhje me çështjen në fjalë, ka rezultuar se çështja objekt denoncimi ka pasur një historik të gjatë në të dy shkallët e gjyqësorit në vitet 2011 – 2018.
102. Në bazë të kallëzimit nga shtetasi I. S. është regjistruar procedimi penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 5.10.2011. Ky vendim është mbështetur edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.9.2013. Ndërsa, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 28.3.2014, ka vendosur prishjen e vendimit dhe dërgimin e akteve Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve. Edhe pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata, Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal. Pas ankimimit nga shtetasi I. S., gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.3.2016, ka vendosur përsëri rrëzimin e kërkesës. Më pas, ai ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, dhe kjo e fundit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjykues, duke urdhëruar thirrjen e personave të kallëzuar për të marrë pjesë në gjykim.
103. Në vitin 2018 çështja i është ngarkuar për gjykim gjyqtarës Armela Hasantari, e cila pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 14.6.2018<sup>21</sup>, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit. Pas ankimit të këtij vendimi nga shtetasi I. S., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 10.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari.
104. Në përfundim të sa më sipër – lidhur me pretendimet e denoncuesit, Komisioni ka konstatuar se çështja gjyqësore në fjalë është regjistruar për t'u gjykuar nga subjekti në datën 27.4.2018. Vendimi është shpallur në datën 14.6.2018 në prani të shtetasis I. S.<sup>22</sup>.
105. Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacion provues lidhur me dorëzimin e vendimit të zbardhur në sekretari dhe të japë shpjegime bindëse në lidhje me sa është pretenduar nga denoncuesi.

<sup>20</sup> Denoncuesi ka paraqitur në cilësinë e provave vendimin për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, datë 9.4.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 28.3.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

<sup>21</sup> Nga analiza e dokumenteve të administruara ka rezultuar se vetëm vendimi nr. \*\*\*, datë 14.6.2018, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari.

<sup>22</sup> Komisioni i është drejtuar gjykatës me kërkesën me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, me qëllim administrimin e vendimit objekt denoncimi. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022, gjykata ka bërë me dije se është në pamundësi për të identifikuar vendimin, pasi nuk përkonin të dhënat e vendimit me numrin e vendimit në numërorët e gjykatës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

106. Subjekti ka parashtruar se arsyetimi i vendimit është bërë brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsytuar, është dorëzuar në sekretari në datën 29.6.2018 – 15 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.
107. Gjithashtu, ajo ka paraqitur në cilësinë e provës një kopje të fletës së regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku regjistrohet depozitimi i vendimeve gjyqësore, për të vërtetuar zbardhjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 14.6.2018, brenda afatit të përcaktuar ligjor.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

108. Komisioni, nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me afatin ligjor të dorëzimit të vendimit të arsytuar, çmon se ato janë bindëse dhe vlerësohen të mjaftueshme në vetvete për të përjashtuar mangësi profesionale nga ana e saj. Gjithashtu, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nisur edhe nga fakti që vendimi në fjalë është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore, konstatohet mungesa e ndonjë shkeljeje etiko-procedurale të kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, as Komisioni nuk ka gjetur ndonjë shkelje etiko-procedurale apo mangësi profesionale nga subjekti lidhur me këtë çështje.

### **2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2018, i shtetases V. D.**

109. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga denoncuesja, Komisioni ka konstatuar se ajo ka paraqitur një ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku, ndër të tjera, ka cituar se: *“Në datën 7.11.2017 kemi paraqitur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ... Pasi është hedhur shorti, padia i ka rënë për shqyrtim gjyqtarës Armela Hasantari. Në datën 18.12.2017, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2017, gjyqtarja ka vendosur kthimin e padisë me të meta procedurale, sepse mungonin aktet provuese”*.
110. Gjithashtu, nga aktet ka rezultuar se pas plotësimit të të metave të padisë denoncuesja i është drejtuar sërish gjykatës. Në këtë rast padia është marrë në shqyrtim nga një tjetër gjyqtarë, e cila ka vendosur kthimin e akteve për shkak se nuk është paguar taksa gjyqësore.
111. Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se denoncuesja nuk ka ngritur pretendime dhe as nuk referon ndonjë fakt apo rrethanë në lidhje me shkelje procedurale që i atribuohen subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të *indicieve*, denoncimi i paraqitur nuk mund të mbahet në konsideratë në funksion të procesit të rivlerësimit.

### **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2018, i BKT-së**

112. Denoncuesi ka ngritur pretendime në lidhje me një çështje penale të iniciuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën BKT-ja është thirrur



në cilësinë e të pandehurit, e kallëzuar nga shtetasi A. D. Ai ka parashtruar se Prokuroria nuk ka arsyetuar në asnjë moment mbi lidhjen shkakësore të veprimeve të të pandehurit me pasojën e ardhur dhe as përgjegjësinë penale të tij. Sipas denoncuesit, të njëjtin qëndrim indiferent ndaj fakteve dhe mungesës së hetimit nga prokuroria ka mbajtur edhe gjyqtarja Armela Hasantari, duke arritur në një konkluzion dhe një vendimmarrje të gabuar<sup>23</sup>.

113. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i denoncuesit se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar duke mbyllur hetimet, ndonëse duket i paprovuar nga dokumentacioni i përcjellë në Komision, lidhet me themelin dhe me logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar, e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat dhe të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar. Për rrjedhojë, ky denoncim e pretendim tejkalon kompetencat kushtetuese të Komisionit dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt hetimi e shqyrtimi në funksion të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

#### **4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2019, i shtetasit A. H.**

114. Denoncuesi ka ngritur pretendime për shkelje të ligjit nga disa gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit. Ai ka pretenduar se vendimi nr. \*\*\*, datë 24.6.2019, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë në shkelje të ligjit, është dhënë në mungesë të tij dhe është mbajtur padrejtsisht në burg, pa iu mundësuar e drejta e ankimit.

115. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar se në datën 24.6.2019 gjyqtarja Armela Hasantari ka marrë në shqyrtim kërkesën e denoncuesit për rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 21.11.2016, me gjyqtar A. K.

116. Komisioni ka analizuar vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit mbi kërkesën e sipërcituar dhe ka konstatuar se subjekti, bazuar në nenet 147, 420/1 dhe 471 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se nuk gjendemi përpara kushteve të rivendosjes në afat, por përpara kushteve të rishikimit të vendimit të formës së prerë. Ky arsyetim është bërë nga subjekti bazuar në faktin se kërkuesi nuk ka qenë prezent personalisht në gjykim, por është përfaqësuar gjatë gjithë gjyqimit nga avokati i caktuar kryesisht<sup>24</sup>.

117. Lidhur me sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të paraqesë dokumentacion provues lidhur me dorëzimin e vendimit të zbardhur në sekretari dhe të japë shpjegime bindëse për vonesën e mundshme.

---

<sup>23</sup> Përgjatë hetimit administrativ, Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022, ka bërë me dije se dosja gjyqësore, që i përket çështjes objekt denoncimi, është transferuar në këtë gjykatë, por lidhur me këtë çështje nuk është planifikuar gjykim.

<sup>24</sup> Komisioni i është drejtuar gjykatës me kërkesën me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, me qëllim administrimin e vendimit objekt denoncimi. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022, gjykata ka bërë me dije se nuk ka rezultuar vendim me të dhënat dhe palët e kërkua.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

118. Subjekti ka parashtruar se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 10.7.2019. Në mbështetje të deklaramit të saj, ajo ka vënë në dispozicion të Komisionit një kopje të fletës së regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që provon zbardhjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 24.6.2019. Subjekti ka sqaruar se, nëse ka pasur ndonjë rast për dorëzimin në sekretari me vonesë, kjo ka ndodhur për shkaqe të pavarura prej saj – dhe se duhen mbajtur në konsideratë edhe vonesat nga sekretaria gjyqësore. Subjekti ka printuar vendimin dhe e është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore për të kryer veprimet e numërtimit dhe qepjes së dosjes, por regjistrimi është bërë një ose disa ditë më vonë për shkak të ngarkesës.
119. Subjekti ka vënë në dispozicion në cilësinë e provës statistikave të gjykatës për vitin 2019, si dhe kopje të fletës së regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku regjistrohet depozitimi i vendimeve gjyqësore. Sipas këtyre statistikave, në vitin 2019 subjektit i janë caktuar me short 508 dosje, nga të cilat ka përfunduar 498. Ndërkohë që, sipas sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale). Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se ngarkesa e saj, sipas të dhënave statistikore për vitin 2019, ka qenë pothuajse pesë herë më e lartë se standardi ligjor.

## **Vlerësimi i trupit gjykues**

120. Trupi gjykues, pas administrimit të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se bazuar në nenin 420/1, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, “Gjykata arsyeton vendimin brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”. Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë faktin se kërkesuesit i është bërë me dije nga gjykata mekanizmi ligjor dhe procedura që duhet të ndiqte për zgjidhjen e çështjes, si dhe faktin se vonesa në rastin konkret, sipas shpjegimeve të subjektit, ka ardhur si rezultat i faktorëve objektivë. Gjykata ka arsyetuar se e drejta e pretenduar nga denoncuesi nuk realizohej përmes ankimit, por nëpërmjet një kërkesë të re drejtuar gjykatës për rishikimin e vendimit të dhënë nga një tjetër gjyqtar në vitin 2016. Në konkludim e konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se vonesa në arsyetimin e vendimit në rastin konkret si një rrethanë e vetme nuk mund të prodhojë pasoja penalizuese lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të znj. Armela Hasantari.

## **LIDHUR ME DISA ÇËSHTJE TË TJERA**

121. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me një artikull të publikuar në median *online*<sup>25</sup>, në të cilin përmendej gjyqtarja Armela Hasantari. Nga analizimi i artikullit në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar si vijon: “Gjykata e Tiranës ka dënuar me 15 vite burg ish-policin N. H., i

<sup>25</sup>[http://gazetareforma.com/ulen-vitet-e-burgut-per-\\*\\*\\*-\\*\\*\\*-kush-jane-gjyqtaret-qe-nuk-kane-kaluar-ende-Vettingun/](http://gazetareforma.com/ulen-vitet-e-burgut-per-***-***-kush-jane-gjyqtaret-qe-nuk-kane-kaluar-ende-Vettingun/)

*cili akuzohej për vrasjen e K. R. ish-efektivi i ‘\*\*\*\*’ do të kryejë vetëm 10 vite burg, për shkak se ka përfituar gjykim të shkurtuar, duke iu ulur dënimi me 1/3-at e afatit. Ai akuzohej për vrasjen me dashje të 25-vjeçarit... Shkurtimi i dënimit shihet i paarsyeshëm. Trupa ishte e përbërë nga tre anëtarë, me në krye gjyqtaren Armela Hasantari”.*

122. Komisioni ka administruar<sup>26</sup> vendimin nr. \*\*\*, datë 14.7.2021, të dhënë nga trupi gjykues, pjesë e të cilit ishte edhe subjekti i rivlerësimit. Nga shqyrtimi i këtij vendimi ka rezultuar se gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurit me 15 vite burgim, uljen e dënimit me 1/3-at, bazuar në nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin përfundimtar të tij me 10 vite burgim. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori i çështjes, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit në fjalë, mospranimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, pranimin e kërkesës së prokurorit për marrjen në pyetje të të pandehurit, prishjen e vendimit të ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar dhe dënimin e tij me 20 vite burgim.
123. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë<sup>27</sup>, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.3.2022, ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohej vetëm në lidhje me masën e dënimit, duke e dënuar të pandehurin N. H. me 18 vite burgim, uljen e dënimit me 1/3-at, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin e tij përfundimisht me 15 vite burgim.
124. Në analizë të dokumentacionit të administruar dhe përshkruar më sipër, Komisioni çmon se, bazuar në nenin 166 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin përcaktohet se *i pandehuri dhe i padituri civil pyeten në qoftë se bëjnë kërkesë ose kur u kërkohet dhe ata japin pëlqimin...*, marrja si provë e thënieve të të pandehurit mundësohet vetëm me dhënien e pëlqimit nga ana e tij. Nisur nga fakti se i pandehuri ka bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar, ai ka pranuar që çështja të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, duke mos marrë asnjë provë tjetër, përfshirë këtu edhe marrjen e tij në pyetje.
125. Në këto kushte, pretendimi i prokurorisë për paligjshmëri të vendimit të ndërmjetëm vetëm mbi shkakun se duhej të merrej si provë pyetja e të pandehurit, sikurse është konkluduar edhe nga Gjykata e Apelit, ka rezultuar i pabazuar.
126. Në lidhje me masën e dënimit të dhënë nga gjykata, Komisioni çmon se konsiderohet si element që lidhet me vlerësimin e rrethanave të faktit, rrezikshmërinë e autorit të veprës, vlerësimin e rrethanave rënduese e lehtësuese apo çdo treguesi tjetër që i vlen gjykatës për të individualizuar dënimin e dhënë për një veprë penale brenda marzheve të dënimit që parashikon ligji. Këto janë elemente që lidhen me korrektësinë e themelit, mbështetur në bindjen e brendshme të këtij disponimi të gjykatës, e cila nuk mund të shërbejë si një faktor që afekton vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit në kuptim të këtij procesi. Për sa kohë masa e

<sup>26</sup> Njëpërmjet kërkesës nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>27</sup> Administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022.

dënimit të dhënë ka qenë brenda marzhit të përcaktuar nga dispozita përkatëse<sup>28</sup>, Komisioni nuk ka evidentuar ndonjë shkelje konkrete apo favorizim të kryer nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

127. Në lidhje me artikullin e publikuar në median *online*, subjekti i rivlerësimit, ndonëse nuk i janë kërkuar shpjegime nga Komisioni, ka deklaruar se çështja penale nr. \*\*\* regj., datë 2.4.2021, regjistrim që i përket të pandehurit N. H., akuzuar për veprën penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.7.2021, vendim unanim i dhënë nga trupi gjykues i përbërë nga tre anëtarë. Masa e dënimit të dhënë nga trupi gjykues, në të cilin ajo ka qenë anëtare, ka qenë brenda marzhit të përcaktuar nga dispozita përkatëse. Në vendimin e sipërcituar janë analizuar të gjitha rrethanat e parashikuara nga neni 47-49 të Kodit Penal, si dhe moskonstatimi i asnjë rrethane nga ato të parashikuara në nenin 50 të Kodit Penal.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

128. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar përmbajtjen e artikullit të publikuar në median *on-line*, të përshkruar më sipër, në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të saj.

129. Në konkluzion lidhur me këtë kriter, trupi gjykues, duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale – për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsye të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit – në këto kushte çmon se znj. Armela Hasantari ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

130. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Armela Hasantari:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

---

<sup>28</sup> Në referencë të nenit 76 të Kodit Penal, Komisioni ka konstatuar se marzhi i dënimit sipas kësaj dispozite është nga 10 deri në 20 vjet.

c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Armela Hasantari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 25.11.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*